



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 gusht 2020

Nr. ref.:RK 1605/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI në

Rastin nr. KI42/20

Parashtrues

Armend Hamiti

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK nr. 797/2019 të 23 dhjetorit 2019 në lidhje me procesin e emërimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtrues i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Armend Hamiti nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës kundërshton dy vendime të Këshillit Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK), lidhur me procesin e emërimit të Kryeprokurorit në Prokurorinë Speciale të Republikës Kosovës (në tekstin e mëtejme: PSRK), përkatësisht: a) Vendimi KPK nr. 699/2019, i 12 nëntorit 2019; dhe, b) Vendimi KPK nr. 797/2019, i 23 dhjetorit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë të vendimeve të kundërshtuara të KPK-së, me të cilët pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë cenuar të drejtat dhe liritë e të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], dhe 110 (3) [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03 / L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Me 28 shkurt 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi Gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).
7. Me 5 mars 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua KPK-së.
8. Më 29 korrik 2020, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Më 1 gusht 2019, KPK-ja miratoi Rregulloren nr. 06/2019 për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorisë të Republikës së Kosovës. Në të njëjtën ditë, KPK vendosi të shpallë konkurs për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale (në tekstin e mëtejme: PSRK) dhe Kryeprokuror të Prokurorisë Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: PTH).

10. Me 14 gusht 2019, KPK-ja shpalli konkurs për pozitën e Kryeprokurorit të PSRK dhe Kryeprokurorit të PTH në Prishtinë. Parashtruesi i kërkesës konkuroi për pozitën e Kryeprokurorit të PSRK.
11. Me 3 shtator 2019, KPK-ja mori vendim për themelim të Paneleve Vlerësuese për emërim të Kryeprokurorit të PSRK dhe Kryeprokurorit të PTH në Prishtinë. Në Pikën II të Vendimit për themelimin e Paneleve Vlerësuese parashikohej themelimi edhe i Komisioneve për Rishqyrtim të procesit të emërimit të Kryeprokurorit të PSRK dhe Kryeprokurorit të PTH në Prishtinë.
12. Më 27 shtator 2019, KPK miratoi listat përfundimtare të kandidatëve për Kryeprokuror në PSRK dhe Kryeprokuror në PTH në Prishtinë. Në listën për Kryeprokuror në PSRK kanë qenë 5 (pesë) kandidatë kurse për Kryeprokuror në PTH në Prishtinë, 4 (katër) kandidatë.
13. Parashtruesi kishte dorëzuar dokumentacionin e kërkuar me qëllim të aplikimit për pozitën Kryeprokuror në PSRK.
14. Më 1 tetor 2019, KPK kishte ftuar (Ftesa nr. KPK nr.579/2019) për intervistë ku figuronin edhe emrat e panelit intervistues.
15. Më 15 tetor 2019, KPK kishte dorëzuar “njoftim përfundimtar” parashtruesit të kërkesës me ç’rast atij i ishte kumtuar lajmi se KPK nuk e kishte votuar për pozitën Kryeprokuror në PSRK. Parashtruesi i kërkesës po ashtu ishte njoftuar: *“ky rezultat ju renditë në pozitën e katërt (4) në konkurrencë me kandidatët e tjerë, dhe nuk ju rendit si kandidat përfundimtar për votim në KPK”*.
16. Më 21 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti kundërshtimin e tij për poentim për pozitën Kryeprokuror në PSRK.
17. Më 2 dhjetor 2019, KPK njoftoi parashtruesin e kërkesës se më 12 nëntor 2019 KPK kishte marrë Vendim (Nr. 699/2019) për miratimin e Rekomandimit të Komisionit për Rishqyrtim për procesin e emërimit të Kryeprokurorit të PSRK. Në atë njoftim thuhej se kundërshtimi i parashtruesit të kërkesës ishte pranuar dhe se ishte kryer plotësimi i “fletëpoentimeve” të 9 tetorit 2019 bazuar në nenin 14 paragrafi 2 i Rregullores nr. 06/2019).
18. Më 9 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti kundërshtim në Komisionin për Rishqyrtim të KPK për procesin e emërimit të Kryeprokurorit të PSRK.
19. Më 23 dhjetor 2019, KPK kishte zgjedhur BI për Kryeprokuror të PSRK me 10 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim”.
20. Më 31 dhjetor 2019, KPK njoftoi parashtruesin e kërkesës se më 23 dhjetor 2019 kishte marrë Vendimin KPK nr. 797/2019 për miratimin e Rekomandimit të Komisionit për Rishqyrtim për procesin e emërimit të Kryeprokurorit të PSRK dhe për refuzimin e kundërshtimit të parashtruesit të kërkesës.
21. Në Vendimin nr. 797/2019 të 23 dhjetorit 2019, KPK kishte arsyetuar:

“Këshilli Prokurorial i Kosovës me datë 23 dhjetor 2019, ka trajtuar Rekomandimin e Komisionit për Rishqyrtim për kundërshtimin e paraqitur nga kandidati Armend Hamiti. Në raportin e Komisionit është rekomanduar Këshillit që të refuzojë këtë kundërshtim.

Këshilli Prokurorial i Kosovës duke trajtuar Raportin e Komisionit ka vlerësuar se kundërshtimi i kandidatit Armend Hamiti është i njëjti me Kundërshtimin e paraqitur herën e parë e për të cilin disa nga pikat e kundërshtuara, Këshilli i ka aprovuar dhe ka kërkuar nga anëtarët e Panelit Vlerësues që të bëjnë plotësimin e arsytetimeve në fletëpoentime siç është kërkuar në kundërshtim të cilët më pas i janë dërguar kandidatit.

Kandidati Armend Hamiti, pas pranimit të fletëpoentimeve të plotësuara sipas kundërshtimit të tij, ka paraqitur përsëri kundërshtim me të njëjtat pretendime duke mos u mbështetur në asnjë provë ashtu siç kërkohet në nenin 14 paragrafi 2 të Rregullores.

Këshilli ka vlerësuar propozimin e Komisionit për Rishqyrtim dhe gjatë shqyrtimit të kundërshtimeve për herë të dytë ka konstatuar se janë përmbushur vërejtjet e paraqitura nga kandidati Armend Hamiti në kundërshtimin e parë, andaj, në mungesë të të gjeturave konkrete të mbështetura në fakte i ka propozuar Këshillit që ky kundërshtim të refuzohet.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve të kandidatit lidhur me procesin e poentimit ku kandidati konsideron se vlerësimi nuk përputhet me arsyetimin, nuk qëndron për faktin se Komisioni për Rishqyrtim dhe Këshilli kanë vlerësuar se anëtarët e Panelit Vlerësues vlerësimet e tyre i kanë dhënë në bazë të paraqitjes së kandidatit në intervistë dhe dokumenteve të cilat kanë qenë subjekt i vlerësimit. Bazuar në Rregullore, kandidati për çdo kategori mund të marr nga 1 poen deri në maksimumin që është paraparë për atë kategori, prandaj mospoentimi në maksimum për Këshillin nuk nënkupton se poentimi është në kundërshtim me arsyetimin, nëse nuk i janë dhënë poenat në maksimum.

Këshilli konsideron se vlerësimi i kandidatit nga anëtarët e panelit vlerësues nuk është në kundërshtim me rregulloren dhe me asnjë dispozitë tjetër. Po ashtu, nuk ka pasur asnjë pasaktësi dhe asnjë gabim teknik gjatë poentimit dhe vlerësimit si dhe të gjitha kategoritë e poentimit janë në harmoni me arsyetimet përkatëse.

Andaj, bazuar në nenin 16 paragrafi 4 të Rregullores ku është përcaktuar që Kundërshtimi duhet të mbështetet në prova e të cilat nuk janë ofruar nga kandidati, Këshilli vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi”.

Pretendimet e parashtresit të kërkesës

22. Parashtresi e kërkesës shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 24 (1) [Barazia para Ligjit] nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 110.3 [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të Kushtetutës.

23. Parashtruesi i kërkesës pohon se në rastin e tij KPK-ja ka marrë dy vendime, kurse duke shikuar praktikën e deritanishme, vlerësimi kushtetues i vendimit të dytë të KPK-së [Vendim KPK nr. 796/2019 i 23 dhjetorit 2019] nga Gjykata është mjeti i fundit efektiv juridik çka nënkupton se janë shteruar të gjitha mjetet juridike.
24. Parashtruesi i kërkesës më tej pohon se shterimi i mjeteve juridike kërkon mjetet juridike të jenë adekuate dhe efektive dhe jo teorike dhe të rreme, pra, mjetet juridike duhet të ofrojnë mundësi të mënjanimi ose ndreqjes së shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës i referohet rastit të GJEDNJ-së Selmouni kundër Francës, Aktgjykim i 28 korrikut 1999.
25. Për sa i përket kriterit për shterim të mjeteve juridike, parashtruesi i kërkesës shton se mjetet juridike jo adekuate dhe jo efektive nuk ka nevojë të shterohen dhe për këtë qëllim i referohet Aktgjykimeve të Gjykatës në rastin nr. KI56/09, Parashtrues Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit dhe rastin nr. KIO6/10 Parashtrues Valon Bislmi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë.
26. Lidhur me kriterin për shterim të mjeteve juridike dhe që nuk ka nevojë të shterohen mjetet juridike që janë jo-adekuate dhe jo-efektive, parashtruesi i kërkesës po ashtu pohon se Gjykata në disa raste “tërësisht të krahasueshme” me rastin e tij, siç janë Aktgjykimet në rastet KI99/14 dhe KI100/14 Parashtrues Shyqyri Sylja dhe Laura Pula; KI34/17 Parashtrues Valdete Daka dhe KI55/17 Parashtrues Tonka Berisha. Në këtë drejtim, mes tjerash, parashtruesi i kërkesës citon Aktgjykimin KI55/17 me ç’rast Gjykata kishte arsyetuar: *“Duke marrë parasysh specifikën e procedurës për zgjedhjen për pozitën e Kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe domosdoshmërinë që kjo të bëhet në kohën e duhur, Gjykata është e mendimit se nuk ka mjet juridik që adreson në mënyrë efektive pretendimet e ngritura nga parashtruesja e kërkesës”*.
27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se garancitë e neneve 24 (1), 31, 32, 54 dhe 110 (3) të Kushtetutës janë shkelur nga Komisionet e KPK-së me rastin e aplikacionit të tij për pozitën kryeprokuror në PSRK sepse: (i) Vendimet e KPK-së janë arbitrare; (ii) ekziston vlerësim kontradiktor për eliminim nga gara; dhe, (iii) parashtruesi nuk ka marrë vendimin për zgjedhjen e BI kryeprokuror i PSRK-së.
28. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Vendimet e kontestuara të KPK-së janë arbitrare për shkak se përmbajnë arsyetime kundërthënëse në mes të Vlerësimit të Parë dhe Vlerësimit të Dytë [...]në fakt Vlerësmi i dytë nuk është veçse një plotësim arbitrar i Vendimit të Parë: ai nuk mund të jetë asnjëherë rishikim i gabimeve origjinale të Vlerësimit të parë, siç do duhej të ishte në esencë[...]Vlerësimi i dytë është mbështetur në statistika fiktive lidhur me suksesin e parashtruesit, të cilat nuk kanë qenë pjesë e Vlerësimit të parë dhe janë prodhuar në ndërkohë mes dy vlerësimeve në mënyrë krejtësisht arbitrare”*.
29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 (1) i KEDNJ-së është i zbatueshëm edhe ndaj procedurave të zhvilluara në KPK sepse kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Parashtruesi i kërkesës

shton se zbatimi i standartit për gjykim të drejtë dhe të paanshëm vlen për procedurat gjyqësore dhe kuasi-gjyqësore dhe kjo është konstatuar nga Gjykata në rastet KI34/17 dhe KI55/17.

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon: (i) shkelje të “parimit të përgjithshëm të barazisë” sepse në Vlerësimin e parë për shkak të poentimit të ulët, ai është mënjanuar nga gara në mënyrë arbitrare në kundërshtim me parimin kushtetues të meritokracisë; dhe se, (ii) objekt i Vlerësimit të dytë kanë qenë gjërat, statistikën dhe rrethanat që fare nuk kanë pasur të bëjnë me Vlerësimin e parë. Parashtruesi i kërkesës shton se kjo situatë është ‘tërësisht e krahueshme’ me rastet KI34/17 dhe KI55/17.
31. Parashtruesi i kërkesës thekson se sipas Rregullores Nr. 06/19 [Paneli vlerësues dhe procedura e intervistimit] thuhet qartë se intervistat dhe procedurat e vlerësimit incizohen. Parashtruesi pretendon se KPK-ja nuk ka njoftuar kandidatët nëse ka pasur incizim të procesit.
32. Lidhur me incizimin e procesit, parashtruesi pretendon: *“Këtë fakt Parashtruesi e ka vënë në dukje në dy kundërshtimet e tij kundër vendimeve të dy trupave të KPK që kanë bërë Vlerësimin e Parë dhe Vlerësimin e Dytë”*.
33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se mungesa e incizimit të procesit cenon parimin e transparencës nga neni 110.3 [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të Kushtetutës dhe po ashtu cenon rëndë paanshmërinë e punës së KPK-së.
34. Parashtruesi i kërkesës kërkon: *“Kërkojmë me respekt që vetë Gjykata Kushtetuese të kërkojë përgjigje zyrtare nga KPK nëse ka pasur dhe cili ka qenë lloji i incizimit”*.
35. Parashtruesi i kërkesës pohon se nuk ka pranuar vendimin për zgjedhjen e BI kryeprokuror i PSRK-së. Sipas parashtruesit të kërkesës kjo përbën cenimin të nenit 32 të Kushtetutës sepse atij i mohohet mundësia që përmes rrugëve gjyqësore dhe ligjore ta kontestojë zgjedhjen e BI kryeprokuror i PSRK-së.
36. Parashtruesi i kërkesës shton se Vendimi i dytë i KPK-së përmban arsytet pse ai është refuzuar por jo edhe pse dhe si është zgjedhur BI kryeprokuror në PSRK.
37. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Në fakt, vetë titulli i Vendimit të Dytë është lidhur me procesin e emërimit të kryeprokurorit të PSRK, jo vendim individual për përzgjedhje. Si i tillë, Vendimi i Dytë nuk jep arsytet e përzgjedhjes së zt. BI në postin e kryeprokurorit të PSRK në Prishtinë. Kjo nuk mund të jetë kështu sepse, në këtë logjikë, Vendimi i dytë del se mund të përjashtohet nga çdo kontroll kushtetues në sistemin juridik-kushtetues të Kosovës, që supozohet që supozohet se është harmonik dhe konzistent dhe që ofron mjete të mjaftueshme juridike për të adresuar çdo cenim të lirive dhe të drejtave kushtetuese”*.
38. Përfundimisht, Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) ta deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të neneve 24 (1) [Barazia para Ligjit], 31 (1) [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në lidhje me nenin 6 (e drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe nenin 110 (1)

dhe (3) [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të Kushtetutës; (iii) të shpall të pavlefshëm Vendimet e Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK nr. 699/2019 të 12 nëntorit 2019 dhe KPK nr. 796/2019 të 23 dhjetorit 2019; (iv) të urdhërojë KPK-që ta kthej në pikën fillestare tërë procesin për pëzgjedhjen e Kryeprokurorit të PSRK-së; (v) të urdhërojë KPK-në që në pajtim me Rregulloren e punës ta informojë Gjykatën për masat e ndërmarra në pajtim me Aktgjykimin e saj.

Vlerësimi i pranueshmërisë

39. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

40. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

41. Gjykata i referohet edhe nenit 47.2 të Ligjit, i cili parashikon:

“[...] Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

42. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës, i cili specifikon:

“(1)

Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjyimit të kundërshtuar.”

43. Gjykata rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike nga neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit dhe rregulli 39 (1) (b) i Rregullores së punës i obligon ata që dëshirojnë që çështjen e tyre ta paraqesin në Gjykatën Kushtetuese që së pari duhet t'i shfrytëzojnë mjetet juridike efektive në dispozicion sipas ligjit kundër aktgjyimit ose vendimit të kundërshtuar.

44. Në këtë mënyrë, gjykatave të rregullta u ofrohet mundësia për t'i korrigjuar gabimet e veta gjatë procedurës së rregullt gjyqësore para se çështja të arrijë në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin që theksohet në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së që mjetet juridike efektive janë të disponueshme në legjislacionin e brendshëm përpara gjykatave të rregullta në lidhje me shkeljen e pretenduar, pavarësisht nëse dispozitat e KEDNJ-së janë bartur apo jo në ligjin kombëtar (shih, inter alia, *Aksoy kundër Turqisë* Aktgjykimi i GJEDNJ-së, paragrafi 51, 18 dhjetor 1996).

45. Parimi është se mekanizmi i mbrojtjes i të drejtave dhe lirive themelore në Gjykatën Kushtetuese është subsidiar në raport me sistemin e rregullt gjyqësor

që mbron të drejtat e njeriut (shih, inter alia, rastin e GJEDNJ-së, *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 7 dhjetorit 1976).

46. Në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të ndjekë në mënyrë të rregullt mjetet juridike që janë të disponueshme dhe të mjaftueshme për të siguruar mundësinë e korrigjimit të shkeljes së pretenduar. Ekzistimi i mjeteve juridike në fjalë duhet të jetë mjaftueshëm i sigurt jo vetëm në teori por edhe në praktikë, dhe nëse kjo nuk është kështu, atyre mjeteve juridike do t'u mungojë qasshmëria dhe efektshmëria e duhur (shih, inter alia, *Vernillo kundër Francës* paragrafi 27 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së të 20 shkurtit 1991, dhe *Dalia kundër Francës*, paragrafi 38 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 19 shkurtit 1998).
47. Gjykatës i takon që të shqyrtojë nëse janë shteruar mjetet juridike, efektive dhe të disponueshme në teori dhe praktikë në kohën relevante, përkatësisht nëse mjeti juridik ka qenë i disponueshëm, që ka mundur të korrigjojë shkeljet në raport me kundërshtimet e parashtrueses së kërkesës dhe se ka mundësuar perspektivë të arsyeshme për sukses (shih, inter alia, *Civet kundër Francës* paragrafët 42-44, të Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 28 shtatorit 1999).
48. Gjykata konsideron se në mënyrë që parashtruesi i kërkesës të lirohet nga detyrimi për të shterur të gjitha mjetet juridike që janë të obligueshme për të, ai duhet të tregojë se: i) mjeti juridik në të vërtetë ishte përdorur, ii) mjeti juridik ishte i papërshtatshëm dhe joefektiv në lidhje me rastin e tij, dhe iii) se kanë ekzistuar rrethanat e veçanta për lirimin e parashtruesit nga detyrimi për të shterur të gjitha mjetet juridike (Shih, rastin nr. KI116/14, *Parashtrues i kërkesës Fadil Selmanaj*, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 janarit 2015).
49. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konteston dy vendime të cilat i ka nxjerrë KPK si rezultat i konkursit për Kryeprokuror të PSRK-së në të cilin ai kishte marrë pjesë. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës sipas rezultateve të arritura gjatë procesit gjithëpërfshirës të përzgjedhjes ka marrë një numër të pamjaftueshëm të pikëve dhe rrjedhimisht është eliminuar nga procedura e mëtutjeshme e përzgjedhjes së Kryeprokurorit të PSRK-së.
50. Gjykata, poashtu, vëren se parashtruesi i kërkesës konsideron se vetë fakti se edhe ai ka aplikuar dhe ka qenë njëri prej kandidatëve për pozitën e Kryeprokurorit të PSRK-së i jep karakter të veçantë dhe e bën pozitën e tij para Gjykatës Kushtetuese më specifike sesa të parashtruesve të tjerë, andaj, ai duhet të lirohet nga obligimi për shterim të të gjitha mjeteve juridike të parashikuara me ligj.
51. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, pas marrjes së vendimeve të KPK-së, drejtpërdrejt iu drejtua Gjykatës Kushtetuese nga e cila kërkoi vlerësimin kushtetues të vendimeve të kontestuara në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë duke e bazuar kërkesën e tij pikërisht në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, më saktësisht në rastet KI99/14, KI100/14, KI34/17 dhe KI55/17, në të cilat Gjykata i kishte liruar parashtruesit e kërkesës nga obligimi për shterim të mëtutjeshëm të mjeteve juridike për shkak të specifikës së pozitave të tyre, respektivisht pozitës në të cilën parashtruesit e kërkesës kishin aplikuar.

52. Gjykata vlerëson se rasti i parashtruesit të të kërkesës dallon dhe nuk është në mënyrë relevante i krahasueshëm me rastet KI99/14 dhe KI100/14, KI34/17 dhe KI55/17, me ç'rast Gjykata ka dhënë arsyetim të detajuar përse parashtruesit e kërkesave në ato raste janë liruar nga obligimi për shterim të mjeteve juridike. (shih paragrafët relevantë lidhur me lirimimin nga obligimi për shterim të mjeteve juridike në rastet nr. KI99/14 dhe KI100/14, *Parashtrues Shyqyri Sylja dhe Laura Pula*, Aktgjykim i 3 korrikut 2014; KI34/17, *Parashtrues Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershorit 2017; KI55/17, *Parashtrues Tonka Berisha*, Aktgjykim i 5 korrikut 2017).
53. Gjykata vëren se në rrethanat e rastit konkret, përveç mundësisë së kundërshtimit të procesit të përzgjedhjes të Kryeprokurorit të PSRK-së në kuadër të KPK-së, ligjet e aplikueshme u referohen edhe mjeteve tjera juridike të përcaktuara përmes Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (në testin e mëtejme: LKA). Gjykata thekson se nenet 13 dhe 14 të LKA-së që ndërlidhen me mundësinë e inicimit të konfliktit administrativ përcaktojnë: (i) konfliktit administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë; (ii) konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurë administrative ankimi nuk është i lejuar; dhe, (iii) konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës apo ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj (shih rastin nr. KI147/18 të Gjykatës Kushtetuese, *Parashtrues Arbër Hadri*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 4 shtatorit 2019, paragrafët 52 dhe 53).
54. Gjykata konsideron se barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e kërkesës dmth ai duhet të provojë përse mjetet juridike në dispozicion nuk janë mjaftueshëm të sigurt jo vetëm në teori por edhe praktikë dhe përse nuk janë të qashme dhe efektive. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar asnjë argument përkitazi me mjetet juridike të lartreferuara dhe nuk ka argumentuar përse ato mjete juridike nuk janë në gjendje të ofrojnë zgjidhje ose nuk ofrojnë asnjë mundësi të arsyeshme për sukses lidhur me pretendimet e tij për shkelje kushtetuese (shih KI147/18, *Parashtrues Arbër Hadri*, cituar më lart, paragrafët 56 dhe 57).
55. Gjykata vlerëson se se lirimi nga obligimi për shterim të mjeteve juridike bëhet vetëm përjashtimisht. Parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se ai ka bërë çdo gjë që në mënyrë të arsyeshme pritet nga ai që të shterojë mjetet juridike (shih rastin e GJEDNJ-së, *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim i 13 nëntorit 2017, paragrafi 116 dhe referencat e përmendura aty). Në të vërtetë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së i referohet “dyshimeve të thjeshta” (*mere doubts*) si arsye të pamjaftueshme për ta liruar një parashtrues nga obligimi për shterim të mjeteve juridike. “Dyshimet e thjeshta” të parashtruesit të kërkesës lidhur me efektshmërinë e një mjeti juridik nuk e lirojnë atë nga obligimi që të orvatet që ta shjterojë atë mjet (shih rastet e GJEDNJ-së *Epozdemir kundër Turqisë* Vendim mbi Pranueshmëri i 31 janarit 2002; *Milosevic kundër Holandës*, Vendim mbi Pranueshmëri i 19 marsit 2002; *Pellegriti kundër Italisë*, Vendim mbi Pranueshmëri i 26 majit 2005; dhe *MPP Golub kundër Ukrainës*, Vendim për Pranueshmëri i 18 tetorit 2005). Përkundrazi, është në interesin e parashtruesit të kërkesës që t'i drejtohet gjykatës së duhur për t'i

dhënë asaj mundësinë që të zhvillojë të drejtat ekzistuese përmes fuqisë së interpretimit (shih rastin e GJEDNJ-së *Çiupercescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 15 qershorit 2010, paragrafi 169).

56. Nga sa më sipër, Gjykata konsideron se përveç faktit që parashtruesi i kërkesës ka cituar rastet KI99/14 dhe KI100/14, KI34/17 dhe KI55/17, ai nuk ka arritur ta provojë lidhmërinë faktike dhe juridike të rastit të tij me rastet në fjalë. Gjykata thekson që arsyetimet e vendimeve tjera gjyqësore duhet të interpretohen në kontekstin dhe në dritën e rrethanave faktike në të cilat janë nxjerrë (shih KI147/18, *Parashtrues Arbër Hadri*, cituar më lart, paragrafi 59 dhe referencat e përmendura aty).
57. Gjykata, më tutje, thekson se parashtruesi i kërkesës në këtë rast është një individ i cili ka mjete të rregullta juridike në dispozicion para gjykatave të rregullta dhe i cili është i autorizuar që sipas nenit 113.7 të Kushtetutës të dorëzojë kërkesë në Gjykatë (shih rastin e Gjykatës KI130/16, *Parashtrues Hamdi Ibrahim*, Aktvendimi për Papranueshmëri, i 7 korrikut 2017, paragrafët 29-33).
58. Gjykata dëshiron të theksojë se në rastin KI145/15 ka trajtuar një kërkesë të ngjashme dhe se më 16 maj 2016, ka nxjerrë Aktvendimin për papranueshmëri sepse parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të cilat, sipas ligjit, i kishte në dispozicion (shih rastin e Gjykatës KI145/15, *Parashtrues Florent Muqaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 5 nëntorit 2015, paragrafët 31-41).
59. Nga sa më sipër, Gjykata konsideron se nuk ka vendim përfundimtar të autoritetit kompetent në këtë rast i cili, në këtë fazë, do të mund të ishte objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese sepse parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive sipas ligjit në fuqi në Republikën e Kosovës.
60. Gjykata i referohet interpretimit të GJEDNJ-së, ku theksohet rëndësia e ndarjes së drejtësisë pa vonesë e cila mund ta rrezikojë efikasitetin dhe besueshmërinë e saj (Shih, ndër të tjera, *H. kundër Francës*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 24 tetorit 1989).
61. Megjithatë, Gjykata thekson se kohëzgjatja e procedurave, në vetvete, nuk e bën joefektiv mjetin juridik. "Arsyeshmëria" e kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit dhe duke iu referuar kritereve si në vijim: ndërlikueshmëria e rastit, sjellja e parashtruesit dhe e autoriteteve relevante si dhe çfarë ka qenë në shqyrtim për parashtruesin në atë kontest (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Frydlender kundër Francës*, Aktgjykim i 27 qershorit 2000).
62. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thjesht supozon se mjeti juridik është joefektiv. Megjithatë, ai nuk mbështet mjaftueshëm supozimin e tillë me prova konkrete. Vetëm pretendimi i thjeshtë i parashtruesit për një kohëzgjatje të mundshme të procedurave paraprakisht, nuk mund të shërbejë si argument për të vlerësuar efektivitetin e mjeteve juridike në dispozicion. (shih KI145/15 *Parashtrues Florent Muqaj*, cituar më lart, paragrafi 35).

63. Gjkata përsëritë se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës t'i shterojë të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë organeve kompetente, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih rastin KI41/09, të Gjykatës Kushtetuese, *Parashtrues AAB-RIINVESET SH.P.K.*, Aktvendim për Papranueshmëri i 21 janarit 2010).
64. Gjkata rikujton arsyetimin e saj në një numër të kërkesave tjera që ka pranuar nga gjyqtarët dhe prokurorët të cilët nuk janë emëruar ose riemëruar. Në këto raste, Gjkata ka vendosur se parashtruesit nuk i kanë shteruar të gjitha mjetet efektive juridike sipas ligjit të Kosovës (Shih Rastin e Gjykatës KI114/10, *Parashtruese Vahide Badivuku*, Aktvendim për Papranueshmëri i 8 majit 2011).
65. Gjkata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të arsyetojë se pse mjetet e rregullta juridike para gjykatave të rregullta për ndonjë arsye nuk i ishin në dispozicion të tij ose ishin joefektive në rrethana të veçanta të çështjes apo që ekzistonin rrethana të veçanta për shkak të të cilave ai do të lirohej nga obligimi për shterim të të gjitha mjeteve juridike.
66. Nga sa më sipër, Gjkata përfundon se kërkesa e parashtruesit kërkesës duhet të shpallet e papranueshme sepse nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike të në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (b) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 29 korrik 2020, njëzëri;

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arteta Rama-Hajrizi